

SUVA GIPSI E LEHTË MP 75 L

Suva gipsi për përpunim me makineri





Të kujdesesh për më të dashurit

Ne e dimë se sa të rëndësishme janë shtëpia dhe familja për secilin nga ne.

Prandaj ne ju ofrojmë disa arsye për të zgjedhur suva gipsi Knauf dhe të lejon që këto produkte të kujdesen për mjedisin dhe të dashurit tuaj.



PËRSE KEMI ZGJEDHUR GIPSIN?

Si një produkt natyral, gipsi është një lëndë e parë e preferuar me aplikim të madh në ndërtim. Siguron izolim të shkëlqyeshëm të zërit, mbrojtje nga zjarri dhe është i lehtë për t'u ricikluar. Gipsi mund të gjendet në suva të gipsit, shtresa me derdhje vetë-niveluese, pllaka gipsi për mure dhe tavane si dhe shumë produkte të tjera. Ky produkt për nga natyra i pastër, është i pranishëm në çdo fazë të ndërtimit. Produktet që përmbajnë gips krijojnë një mikroklimë komode dhe të ekuilibruar, nuk kanë erë, janë të butë ndaj lëkurës së njeriut dhe nuk lëshojnë substanca të dëmshme.

Jo vetëm industria e ndërtimit ka zbuluar cilësitë superiore të gipsit natyror. Prania e tij serioze është e dukshme edhe në mjekësi, farmaci, art, pajisje sanitare, ushqim, kozmetikë dhe shumë më tepër.





Suva gipsi e lehtë MP 75 L

Suva gipsi **MP 75 L** për makineri, është një përzierje e thatë e përgaditur paraprakisht në fabrikë, me bazë gipsi ndërtimor dhe me aditivë special të lehtë për të përfituar sipërfaqe të lëmuara të mureve dhe tavaneve. Është e destinuar për aplikim me makineri si suva një-shtresore në ambiente të brendshme. Përzierja është me performancë të lartë dhe e lehtë për t'u përpunuar. Mund të aplikohet për të gjitha llojet me bazë minerale.



TË DHËNA TEKNIKE

MP 75 L

Fushat e aplikimit

Suvaja përdoret për të krijuar sipërfaqe të lëmuara në muret dhe tavanet e brendshme. Mund të aplikohet si suva një-shtresore në:

- Të gjitha llojet e mureve me blloka dhe mureve betoni
- Në të gjitha dhomat me lagështi normale nga bodrumi deri në tavan, p.sh. tualete në shkolla, banjo në hotele, blloqe banimi, spitale dhe shtëpi sociale
- Për të krijuar sipërfaqe me nivel cilësie "Q1-Q4 të lëmuara" si dhe "Q1-Q4 të patinuara". "Q4 të lëmuara" në kombinim me një nga produktet Knauf Gips Finish, Knauf Extra Finish, Knauf Biofinish PRO, Knauf Finitura
- Si bazë për mbulesat e mëposhme ose tapete
- Si bazë për vendosjen e pllakave keramike
- Si bazë për suva përfundimtare.

Trashësia e aplikimit

Trashësia mesatare e suvasë - 10 mm, trashësia minimale - 8 mm, Kabllot elektrikë të sheshtë duhet të mbulohen me të paktën një shtresë suva 5 mm.

Në raste të veçanta, mbi mur mund të aplikohet suva me një shtresë të vetme deri në 50 mm trashësi.

Koha e perpunimit te suvase

Në varësi të bazës - rreth 180 min.

Trashësi mesatare suvaje:	10 mm (trashësi minim. 8 mm)
Pesha specifike:	~ 800 kg/m ³
Kokrriza:	deri në 1,2 mm
Frytshmëria:	100 kg = ~ 125 L llaç
Konsumi:	0,8 kg/mm dhe m ²
Koha e tharjes:	mesatarisht 14 ditë (në varësi të trashësisë së suvasë, lagështirës së ambjentit, tempera- turës dhe ajrimit)
Fortësia në shtypje e sferës:	8,0 N/mm ²
Përkuelshmëria:	1,3 N/mm ²
Fortësia në shtypje:	> 2,5 N/mm ²
Pesha në ambjent:	~ 1.000 kg/m ³
Koeficienti i rezistencës ndaj difuzionit të avujve μ:	~ 5
Aftësia e përcjellshmërisë së nxehtësisë λ:	0,28 W/mK

PËRSE GIPSIN

PËR APLIKIM TË LEHTË

Ekstremisht i lehtë

Për shkak të përmbajtjes së saj perlite, suvaja ka një peshë jashtëzakonisht të ulët në krahasim me suvatë e tjera si ajo gëlqere ose çimento. Kjo ka një rëndësi të veçantë në ndërtimin e ndërtesave të larta, duke lejuar një lehtësim serioz të strukturës, e cila sjell përfitime për investorët. Vëllimi i ulët është gjithashtu përparësia më e madhe që lehtëson zbatimin e punimeve.

Shkallë e ulët konsumi

Suvaja e lehtë Knauf ka një shkallë jashtëzakonisht të ulët të konsumit. Një thes i vetëm 30 Kg mund të mbushë rreth 3.70m² sipërfaqe të përsosur.

Shkurton kohën e ndërtimit

Suvaja e gipsit Knauf zvogëlon kohën e tharjes me 2 deri në 3 herë. Për krahasim, ajo thahet plotësisht dhe fiton forcë gjatë një periudhe prej 10 deri në 14 ditë, ndërsa për të njëjtën trashësi të suvasë së çimentos i janë të nevojshme deri në 28 ditë.

PËR NJË MJEDIS JETESE TË SHËNDETSHËM

Izolimi i nxehtësisë dhe zërit

Suvaja dhe stuko e gipsit shpejt dhe lehtë përthithin nxehtësinë. Nëse temperatura e mureve dhe ajo në dhomë është e përafërt, atëherë personi në atë dhomë do të ndihet më rehat. Kjo gjendje plotësohet plotësisht nga suvatë tona të gipsit me një koeficient të përçueshmërisë termike = 0.25 deri në 0.35 W / mK. Me suvanë e gipsit Knauf do të krijoni rehati të lartë për të jetuar dhe kurseni energji.

Siguria nga zjarri

CaSO₄ · x2H₂O, formula kimike e gipsit tregon se struktura e tij e kristal të përmban 2 molekula uji. Gjatë veprimit termik, lëshohet avull uji i cili shërben si një parandalues për përhapjen e zjarrit.

Praktika dhe gama e gjere e aplikimit

Në bodrume, tavane, kuzhina, madje edhe në banjo – suvaja e gipsit mund të përdoret kudo. Suvaja prej gipsi është rezistente ndaj rënies, nguljes së kunjave dhe montimit të vidave, duke lehtësuar kështu modelimin e brendshëm.

PËR SIGURI DHE REHATI

Difuzioni i avullit

Lagështia në banesa po ndryshon vazhdimisht. Lagështia formohet duke bërë dush, gatime, larje si dhe gjatë frymëmarrjes. Suvatë e gipsit janë në gjendje të krijojnë një "klimë të këndshme" në dhomë falë aftësisë së tyre për të thithur dhe përhapur lagështirën. Gipsi ka të njëjtin pH si ajo e lëkurës së njeriut dhe nuk lëshon erë

Mjedis i shëndetshëm

Shtëpia dhe mjedisi ku banojmë reflekton në shëndetin tonë. Përdorimi i suvasë së gipsit cilësor ka një efekt të drejtpërdrejtë dhe të këndshëm mbi mjedisin e shëndetshëm në shtëpi dhe në vendin e punës.

Suvatë Knauf janë të bëra plotësisht nga produkt natyral i gipsit. Gipsi nuk lëshon substanca dhe avuj të dëmshëm në ambientet tona të jetesës.

SUVA **MP 75 L**





SUVA GIPSI E LEHTË MP 75 L



NA KONTAKTONI

Qendra e Informacionit për Kujdesin ndaj Klientit - Na Kontaktoni për një konsultim falas dhe përfitoni nga përvoja jonë disavjeçare!

> Tel: 038 733 320



BROSHURA INFORMUESE

Praktikat dhe veçoritë më të mira për implementimin e sistemeve Knauf. Informacione të përditësuara mbi ndërtimin modern. Jini të informuar!



KNAUF WEBSITE

Informacione teknike në lidhje me produktet tona, zgjidhje të gatshme dhe informacione rreth rrjetit tonë të shpërndarjes. Këto klikime ia vlejnë

> www.knauf.al
> info@knauf-ks.com

E drejta për të bërë ndryshime teknike është e rezervuar. Vetëm botimi aktual është i vlefshëm. Garancia jonë vlen vetëm për cilësinë e patëmetë të materialit tonë. Karakteristikat strukturore, statike dhe ndërtimore-fizike të sistemeve Knauf mund të arrihen me përdorimin e komponentëve të veçantë ose produkteve të tjera vetëm me miratimin e shprehur të Knauf Bulgaria shpk. Të dhënat e kostos, sasisë dhe performancës janë vlera praktike që nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt në rast të devijimeve nga kushtet e përcaktuara. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ndryshimet, emetimet dhe kopjet fotomekanike, duke përfshirë në formën e fragmenteve, vetëm me lejen e shprehur të Knauf shpk.

Knauf Kosova
"Radovan Zogovic" Nr.117, Arberi,
Prishtine, Kosove
Tel: +383 38 733 320
www.knauf.al
info@knauf-ks.com



www.knauf.al



Knauf KOSOVA



[knauf.rks](https://www.instagram.com/knauf.rks)



Knauf RKS